



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 9869

NR. VENDIMI 6710
Nr. 6710 Vendimi

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES“

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTAR : Ilir ÇELIKU

Asistuar nga sekretarja gjyqesore **Ornela Marashi**, sot më date 28.07.2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile me pale ;

PADITËS: Shoqeria “***” shpk, perfaqesohet nga *** i biri i *** dhe i *** i dtl *** lindur ne *** dhe banues ne *** ,identifikuar me Id *** , perfaqesuar ne gjykim nga juristja *** :

I PADITUR : ***,me adrese: *** , perfaqesuar me procure te posacme me nr *** dt ***nga ***.(ne mungese)

PERSON I TRETE: Drejtoria e Pergjithshme e Patentave dhe Markave, perfaqesuar me autorizimin e dt 11.07.2016 nga ***.(ne mungese)

OBJEKT: Konstatimin e perdorimit te paautorizuar te markes tregtare 'BAR ARTISTI' e rregjistruar kjo e fundit nga mbajtesi i se drejtes prane drejtorise se pergjithshme te patentave dhe markave me nr. rregjistrimi kombetar *** nga shoqeria ***shpk.

Ndalimin e perdorimit te markes tregtare 'BAR ARTISTI' ne publikimin dhe reklamimin e sherbimeve nga palet e paditura.

Konstatimin e konkurrences se pandershme nga

palet e paditura.

Vendosjen e mases se sigurise per sa me siper per subjektin shkeles deri ne marrjen e nje vendimi te gjykates.

BAZA LIGJORE : Neni 348 I K.Pr.Civile,Neni 638,639,202,204 e vijues K.Civil.Ligji Nr 9947 dt 07.07.2008 “Per pronesine Industriale” neni 156 e ne vijim

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqsor, pasi administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet e palës paditëse Shoqeria “****” sh.p.k., të cilët kërkuan pranimin e kërkesë-padisë, si dëgjoi të paditurin ***, që kërkuan rrezimin e padisë sit ë pa mbështetur në ligj e në prova, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi:

V Ë R E N

Se paditësi Shoqeria “****” sh.p.k., ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesë-padinë me objekt: *1.Konstatimin e perdorimit te paautorizuar te markes tregtare 'BAR ARTISTI' e rregjistruar kjo e fundit nga mbajtësi i se drejtes prane drejtorise se pergjithshme te patentave dhe markave me nr. rregjistrimi kombetar *** nga shoqeria *** shpk. 2.Ndalimin e perdorimit te markes tregtare 'BAR ARTISTI' ne publikimin dhe reklamimin e sherbimeve nga palet e paditura. 3.Konstatimin e konkurrences se pandershme nga palet e paditura. 4.Vendosjen e mases se sigurise per sa me siper per subjektin shkeles deri ne marrjen e nje vendimi te gjykates*

Kjo padi përmban të gjithë elementët ligjor si ndërgjyqësinë, objektin dhe shkakun e saj.

Para shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesë padisë, gjykata mbështetur në nenet 348 të K. Pr. Civile, konstatoi se kjo çështje civile tregëtare hyn në juridiksionin gjyqësor civil dhe se ajo është kompetente për zgjidhjen e kësaj mosmarrëvëshje. Gjithashtu gjykata konstatoi se pala paditëse ka legjitimimin për ngritjen e kësaj padie.

Gjithashtu, në vështrim të neneve 71, 72 dhe 73 të K.Pr.Civile, Gjykata çmoi se nuk ekzistojnë për trupin gjykues shkaqe papajtueshmërie ose përjashtimi nga ky gjykim.

Po kështu në zbatim të kërkesave të nenit 35 të K.Pr.Civile, gjykimi i kësaj çështje u zhvillua nga një gjyqtar i vetëm.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se:

Shoqëria “****” sh.p.k. është subjektit i të drejtës tregëtare shqipëtare e organizuar në formën e “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) *** me objekt të veprimtarisë të saj: ("Ruajtje

dhe Siguri Fizike, Tregetim me shumice dhe pakice si dhe import - eksport te produkteve ushqimore, pijeve alokolike si dhe te lendeve te para. Veprimtari ne fushen e transportit te mallrave dhe pasagjereve brenda dhe jashte vendit, me mjetet e shoqerise dhe te treteve. Veprimtari ne fushen e ndertimit. Restorant. Importim i makinerive e linjave te prodhimit e paketimit te ujit, pijeve e te mallrave ushqimore. Veprimtari ne prodhimin e paketimin e ujit, pijeve e te mallrave ushqimore." Kjo shoqëri ka si Administrator *** dhe ortak të shoqërisë me nga ***% të pjesëmarrjes në kapital janë *** dhe ***.

Rezulton se Shoqëria “****” sh.p.k. perveç te tjerave ne aktivitetet e saj tregtare është pronar i regjistrimit për markën tregtare “**BAR ARTISTI**” me numër regjistrimi kombëtar *** me datë rregjistrimi 09.12.2015, me të drejta të plota sipas ligjit.

Paditësi Shoqëria “**” sh.p.k. i është drejtuar gjykatës me padinë objekt shqyrtimi duke pretenduar se:**

Mbajtësi i së drejtës (Pronari) i kësaj marke tregtare është vënë në dijeni se * i regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT *** ka në përdorim në mënyrë të pa autorizuar markën me regjistrim kombëtar “BAR ARTISTI”, me numër regjistrimi kombëtar *** të regjistruar ligjërisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave. Fillimisht paditësi ne datën 01 shkurt 2016 i është drejtuar palës së paditur, subjektit ***, me një njoftim ne lidhje me shkeljen e te drejtes se markes tregtare “BAR ARTISTI ” në pronësi të mbajtësit te se drejtes Shoqëria *** Sh.p.k., duke i kerkuar gjithashtu ndalimin e perdorimit te saj dhe zgjidhjen jashtëgjyqësore të konfliktit. Pavarësisht këtij njoftimi, nuk është kryer asnjë veprim nga pala e paditur për të mos mbajtur në përdorim markën tregtare “ BAR ARTISTI”. Duke ju referuar vizualisht marka në pronësi të mbajtësit të së drejtës *** dhe ai i perdoruesit te New Artist ka element vizual identik ose të ngjashëm me markën e mbajtësit të së drejtës, e bardhë, e kuqe, blu, e zezë, ngjyrë qumështi. Ciklamin; e bardhë; e zezë Elementët figurative të markës së publikuar. Krahasimi i shenjave - Vizualisht IDENTIKE, shenjat janë ekstremisht të ngjashme, pothuajse identike. Të dyja markat janë marka fjalë të stilizuar, dhe janë të stilizuara në të njëjtën mënyrë; kanë të njëjtën strukturë, janë marka të përbërë nga e njëjta ijalë “Artist’ të cilat kanë të njëjtat ngjyra ngjyra ciklaminë e cila është cilësuar si ngjyra e markës së aplikuar për regjistrim ka nuancat e ngjyrës së kuqe dhe për këtë arsye ngjajnë si identike. Pra në moment të caktuara ngjyra “çiklaminë” nuk ka asnjë ndryshim nga ngjyra e kuqe dhe sado i vëmendshëm të jetë një konsumator nuk mund të bëjë dallimin nga ngjyra e kuqe. Ndërsa sa i përket parashtesës NEW (përkthyer e re/i ri) në këtë rast të krijon vetëm idenë se ky bar “New artist” është një bar i ri rrjedhojë e Bar Artistit duke qënë se të gjithë elementët i kanë njëlloj. Ngjashmëria FONETIKE Nga pikëpamja fonetike marka objekt**

kundërshtimi kanë ngjashmëri pothuajse IDENTIKE më njëra tjetrën sa kohë në gjuhën shqipe kemi specifikën që sikundër është e shkruar ashtu dhe lexohet në këto kushte duke i gërmëzuar të dyja markat rezultati do të jetë si më poshtë: Bar Artisti, duke qënë se përfshin shërbime bari leximi në këtë është Artisti. Vs NewArtist, duke qënë se përfshin shërbime bari leximi në këtë është Artisti. Tingëllimi i të dyja markave është identik me njëri tjetrin. Në përfundim markat midis tyre janë identike midis tyre në aspektin fonetikë. Parashtesa NEW edhe në këtë rast nuk ka asnjë rol sipas shpjegimit të cilin e dhamë edhe më sipër. Klasa e mallrave dhe shërbimeve : Sa i përket klasës së mallrave dhe shërbimeve duhet theksuar se të dy këto marka përfaqësojnë marka shërbimi ku të dyja janë të mbrojtura për klasën 43 ku marka e mbrojtur Bar Artisti ka mbrojtur “ Shërbime në fushën e restorantit, ushqime dhe pije; shërbime katering, shërbim bari, restorant, restorant me vetëshërbim, kafeteri; snack bar” ndërsa perdoruesi ushtron aktivitetin e bar kafe “New Artist”. Pra, pavarsisht se është e thënë me fjalë të ndryshme të dyja markat përfaqësojnë të njëjtin shërbim dhe tiparet e aktivitetit që zhvillohen nën emërtimin e markës së kundërshtuar janë të njëjta me ato të markës Bar Artisti, pra përfshin shërbimin e bar kafe i cili është edhe lloji i aktivitetit kryesor për të cilin është mbrojtur marka. Mundësia e konfuzionit lek konsumatori. Në vijim të pretendimeve për ngjashmëri ndërmjet markave duke parashtruar si fakt idenë e të njëjtit imazh apo shërbim drejt konsumatorit, pra kemi konfuzion se flitet për të njëjtin emër, të njëjtin imazh dhe si rrjedhim mendohet i njëjti shërbim, me të njëjtin personel. Gjithashtu nga vetë jetëgjatësia jonë në treg ky emër identifikohet me adresën tonë pranë Rrugës së Elbasanit pasi ne ushtrojmë veprimtarinë në shërbimin e bar-kafe me emërtimin Bar Artisti aty që prej vitit 2001 pra plot 15 vite. Në këto kushte pala e paditur ka shkelur dhe po shkel të drejtat e fituara nga rregjistrimi i markës tonë duke sjellë pasojë ç'orientimin e konsumatorit, prishjen dhe humbjen e reputacionit tonë në qarkullimin tregtar duke na sjelle për pasojë dëm ekonomik dhe moral. Pra, si palë paditëse më vijnë dëme ekonomike dhe prishje imazhi nga subjekti i cili zhvillon aktivitetin e tij nën emërtimin tregtar “ Bar Artisti”. Lloji i shërbimeve që ofron ky subjekt është i njëjtë më llojin e shërbimeve që ofrojmë edhe ne ,pra bar kafe, në kushte te tilla ne ndodhemi para prishjes së imazhit dhe konkurrencës së pandershme. Në kushtet ku nuk ka mundëri të realizojë një të drejtë të pretenduar në rrugë mirkuptimi paditësi me padinë objekt shqyrtimi kërkon gjyqësisht pranimin e padisë sipas objektit.

I padituri * gjatë shpjegimeve në gjykim pretendoi se :**

Objekti i kerkese ka te beje me heqjen e emrit ARTISTI nga lokali ku ushtron Z. * Bar Artisti, te cilen e kemi ezauruar dhe ne mjediset e tij nuk ka me emrin e mesiperm. Kemi sjelle prane gjyaktes dhe provat.**

Nderkohe persa i takon pretendimit per perdorimin e markes New Artist Lounge, qe pretendon pala paditese, kerkojme rrezimin e kerkese padise per kete pjese te padise, duke qene se marka ne fjale , ka numer aplikimi *, dhe eshte aplikuar nga Z. ***, me numer NIPT ***, e cila aktualisht eshte ne proces apelimi me DPPM, si dhe nuk eshte personi juridik i paditur i ketij procesi gjyqesor. Per keto shkaqe kerkon nga Gjykata rrezimin e padise si te pa mbeshtetur ne ligj e ne prova.**

Gjykata bazuar në nenet 16, 20 dhe 31 të K.Pr.Civile, duke i bërë një cilësim të saktë fakteve dhe të veprimeve që lidhen me këtë mosmarrëveshje, duke u mbështetur në mjetet provuese, shpjegimet, dokumentat e provat e tjera të sjella nga palët, të cilat kanë qënë në gjendje të debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit, përfundimisht konkludon se pretendimet e palës paditëse janë të bazuara në prova e në ligj dhe si të tilla, arrin në përfundimin se padia duhet të pranohet, me arsyetimin si më poshtë:

Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi lidhet me perdorimin e markes tregtare “BAR ARTISTI” e regjistruar rregullisht prane Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave me numër regjistrimi kombëtar *** me datë regjistrimi 09.12.2015, me të drejta të plota, ku sipas paditesit kjo marke perdoret nga i padituri ne aktivitetin e bar kafe “New Artist”.

Gjykata verën se, Neni 6 i Konventës së Parisit përcakton se, kushtet për aplikimin dhe regjistrimin e markave do të përcaktohen në çdo vend anëtar të Bashkësisë sipas legjislacionit kombëtar. Po ashtu kjo Konventë, e cila është ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr.8992, datë 30.01.2003 duke u bërë pjesë e të drejtës tonë të brendshme parashikon se, çdo markë e regjistruar rregullisht në vendin e origjinës do të pranohet për aplikim dhe do të mbrohet, duke sanksionuar në këtë mënyrë parimin e trajtimit jo diskriminues të aplikimeve të qytetarëve të vendeve të tjera anëtare të Bashkësisë dhe garantimit të mbrojtjes që duhet të gëzojnë ata në atë vend.

Lidhur me pretendimin e Konstatimin e perdorimit te paautorizuar te markes tregtare “BAR ARTISTI” nga ana e pales se paditur, u provua gjyqesisht se kjo marke tregtare eshte ne pronesi te pales paditese, dhe fakti qe kjo marke eshte e regjistruar rregullisht ne autoritetin pergjegjes, ajo gezojne mbrojte ligjore qe ne momentin e regjistrimit te saj dhe ç’do subjekt tregetar institucion apo shtet, i njeh dhe i pranon ato si te mireqena pavaresisht kohes se regjistrimit te saj.

Gjykata verën se, Neni 156 pika 4 i Ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Per pronesine Industriale” përcakton se: *“Të drejtat, që i njihen pronarit të markës së regjistruar, sipas këtij neni, i njihen edhe pronarit të markës së mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimin e shkronjës "ç" të*

pikës 5 të nenit 143 të këtij ligji”. Nga ana tjetër Neni 143 pika 5, germa “ç” e ligjit përcakton se: “Marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPM-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare.

Kriteret ligjore të përcaktuara me sipër para në raport me Konventën që ti japin një marke statusin “marke e mirënjohur” kërkojnë nga gjykata që vlerësimin e tyre ta bëjë në përputhje me kuptimin dhe qëllimin që kanë në vetvete këto terma të përdorura në ligj para në raport me rrethanat konkrete. Kështu koncepti “përdorim” nënkupton për gjykatën se pari përdorimin e saj minimalisht në një grup të caktuar të interesuarish dhe maksimalisht për publikun e gjere dhe se dyti kohezgjatja e këtij përdorimi përben kriter tjetër vlerësues për gjykatën për dhenien e këtij statusi. Koncepti i “reklamimit ose publikimit” lidhet me evidentimin e kesaj marke nepermjet formave te ndryshme te te berit publike si reklama, spote publicitare, postera, flete-palosje etj.

U provua gjyqesisht se marka tregtare “Bar Artisti” është e mirënjohur në tregun shqiptar për sa kohë që ajo si e tillë është reklamuar që nga viti 1998 nga Shoqëria “***” sh.p.k. Nga pala paditese u provua se përveç se është një marke e regjistruar rregullisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave me numër regjistrimi kombëtar *** me datë regjistrimi 09.12.2015, me të drejta të plota, kjo marke tregtare është bere e mirënjohur edhe në sektorin publik nepermjet ofrimit te shërbimeve bar-kafe me emërtimin Bar Artisti që prej vitit 2001 dhe nga jetëgjatësia e kesaj marke në treg ky emër identifikohet me adresën e shoqërisë pranë Rrugës së Elbasanit. Pra standartet ndërkombëtare e të qenurit marke e mirënjohur në territorin shqiptar nga pala paditese plotësohen për sa kohë që emiri i kesaj marke për më tepër se 10 vjet është reklamuar në një grup shoqëror të gjere.

Gjykata vëren se, Neni 638 i Kodit Civil parashikon se: *Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shënjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që: 1. përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; 2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit; 3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.* Ndërsa Neni 639 i Kodit Civil parashikon se: *Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të*

zhduken pasojat. Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin.

Gjykata për sa u arsyetua me lartë vlereson se është i vertetuar fakti që përdorimi nga i padituri në aktivitetin tregëtar bar kafe me emërtimin “*New Artist*” që është prone e paditesit si markë, kryhet konkurrence e pandershme ndaj duhet të ndalohej. Ndaj disponohet për pranimin e padisë duke disponuar për ndalimin e përdorimit të kësaj markë të regjistruar nga paditesi për faktin që është e regjistruar në territorin shqiptar dhe gëzon statusin e markës së mirënjohur, kjo në mbështetje të pikës 3 të Nenit 6 *bis* të Konventës së Parisit dhe kuadrit ligjor të legjislacionit të brendshëm Nenit 143/5/ç dhe 156/a të ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Për pronësinë Industriale”.

Si përfundim gjykata bazuar në nenet 6, 10, 12, 14, 16, 20, 28, 29 dhe 31 të Kodit të Procedurës Civile, duke i bërë një cilësim të saktë fakteve dhe të veprimeve që lidhen me këtë mosmarrëveshje, në analizë të provave shkresore të paraqitura nga palët, si dhe në vështrim të ligjit material nenet 638, 639 të K.Civil të ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Për pronësinë Industriale” dhe të Konventës së Parisit Gjykata konkludon në pranimin e padisë si të bazuar në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARESYE

Gjykata bazuar në nenet 126, 306, 309 dhe 310, të K.Pr.Civile,

V E N D O S I

- Pranimin e Kërkesë- Padisë.
- Detyrimin e të paditurit *** të ndalojë përdorimin e metejshëm të markave tregëtare « Bar Artisti » dhe « New Artist »
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.
- Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes për palën paditese present, kurse për palën në mungesë ky afat fillon nga e nesërmja e marrjes së dëgjimit.
- U shpall sot më datë 28.07.2016 në Tiranë.

SEKRETARE

GJYQTAR

**ORNELA MARASHI
ÇELIKU**

ILIR

Shpenzimet gjyqesore

Takse padia: *** leke